

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.02.2025*

4.02.2025

Ora 10:04

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik për periudhën 26 janar – 1 shkurt 2025”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu, znj. B. Ereqi.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëmëngjes! Në seancën e sotme kemi në rend dite:

Projektvendimin që lidhet me vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik për periudhën 26 janar – 1 shkurt 2025.

Ndërkohë nga seancat e kaluara shpalljen e vendimit “Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Cërrik, për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”.

Dhe, projektvendimin “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Erin Gjoni, anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, Po, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Znj. P. Doçaj: Po, faleminderit! Në lidhje me raportimin e veprimtarive publike në ndërfaqen e raportimeve të institucioneve NRI, për periudhën 26 janar – 1 shkurt 2025 si vijon:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.02.2025*

27 institucione publike të reja janë regjistruar gjatë kësaj periudhe në ndërfaqe dhe kanë akses për të raportuar veprimtari.

299 raportime janë kryer në total,

294 postime janë aktive dhe,

5 janë aktivitete të ndaluara.

Këto 5 aktivitete të ndaluara, si veprimtari të ndaluara për shkak të raportimit jashtë afateve ligjore janë si më poshtë vijon:

Një veprimtari Bashkia Pukë;

Një veprimtari e Zyrës Vendore Arsimore Peqin.

Një veprimtari Bashkia Librazhd;

Një veprimtari Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë;

Një veprimtari Drejtoria Vendore e Policisë Fier.

Në raportimet e monitoruesve në terren, nuk rezulton që të ketë ndonjë gjetje në lidhje me veprimtaritë e institucioneve. Megjithatë, ne propozojmë fillimin e hetimit administrativ për këto pesë institucione që kanë deklaruar jashtë afateve ligjore. Bashkëlidhur dhe projektvendimi përkatës.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë do të vendosim fillimin administrativ, ndaj:

- Bashkisë Pukë;
- Zyrës Vendore Arsimore Peqin;
- Bashkisë Librazhd;
- Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë dhe,
- Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.

Vendim nr. 61

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.02.2025*

4.02.2025

Ora 10:06

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë
Cërrik, për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”.**

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu, znj. B. Ereqi.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Znj. P. Doçaj: Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin administrativ për Bashkinë Cërrik, ka raportuar në ndërfaqe një veprimtari jashtë afatit ligjor. Nga ana jonë është kërkuar personi përgjegjës për raportim në Bashkinë Cërrik për të mësuar pretendimet se pse është raportuar ky aktivitet jashtë afatit ligjor. Na ka raportuar se në momentin që është deklaruar jashtë afatit ligjor, nuk është kryer më kjo veprimtari. Nuk është zhvilluar më dhe e kanë raportuar në email që nuk është zhvilluar kjo veprimtari. Për këtë motiv, ne mendojmë se duhet të pushohet hetimi administrativ i Bashkisë Cërrik, pasi veprimtaria nuk është në ato ndalime të nenit 92 të Kodit Zgjedhor. Bashkëlidhur dhe projektvendimi përkatës.

Z. I. Celibashi: Me pak fjalë e kanë raportuar është ndaluar dhe nuk e kanë zhvilluar.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.02.2025*

Znj. P. Doçaj: Po nuk e kanë zhvilluar.

Z. I. Celibashi: Dakord! Faleminderit! Atëherë, do të vendosim pushimin administrativ për këtë çështje, për Bashkinë Cërrik.

Vendim nr. 62

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.02.2025*

4.02.2025

Ora 10:07

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues zotin Erin Gjoni, anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu, znj. B. Ereqi.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës!

Znj. L. Veliu: Zoti Erin Gjoni është propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialdemokrate, si kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023. Pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit, ku nga verifikimi i të dhënave nuk rezulton të jetë deklaruar asnjë e dhënë që lidhet me parashikimet për ndalim në ligjin 138/2015. KQZ ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore dhe Zyra e Gjendjes Civile. Gjithashtu KQZ ka vendosur t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent për verifikimin e deklarimeve të bëra. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.02.2025*

dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, konstaton se: si pasojë e heqjes dorë nga mandati i anëtarit të këshilltarit bashkiak nga ana e zotit Erin Pjetër Gjoni, ky shtetas nuk është më subjekt i ligjit. Komisioneri nuk mund të shprehet me vendimmarrje për çështjen objekt shqyrtimi, për aq kohë sa ky subjekt nuk ka marrë mandat. Komisioneri mund të shprehet vetëm kur përmbushen kushtet ligjore të mos kandidimit, mos zgjedhshmërisë, apo mbarimit të mandatit për rastet e parashikuara në ligjin 138/2015.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë meqenëse subjekti vetëdeklarues ka dhënë dorëheqjen nga funksioni i tij publik si anëtar i këshillit bashkiak, do të vendosim pushimin e shqyrtimit administrativ për këtë rast. Mirë, çështje të tjera nuk kemi në rend dite, faleminderit seanca mbyllet!

Vendim nr. __

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

